

Data 04.09.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Pyllëzim me akacie”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime të pyllëzimit 77231600-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës

Fondi limit i procedurës është: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **26,637,405 (njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesë) lekë pa Tvsh ose 289,159.84 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë e katër) euro pa tvsh.** Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankës të Shqipërisë datë 04.09.2026 është 92.12.

Vlerë kjo e ndarë sipas viteve mëposhtë:

Viti I: **14,085,807 (katërmëdhjetë milion e tetëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e shtatë) lekë pa tvsh, ose 152,907.15 (njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatë pikë pesëmbëdhjetë) euro pa tvsh.**

Viti II: **8,400,070 (tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh ose 91,186.17 (nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëmbëdhjetë) euro pa tvsh.**

Viti III: **4,151,528 (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë pa tvsh ose 45,066.52 (dyzet e pesë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pike pesëdhjetë e dy) euro pa tvsh.**

Justifikim për mosndarje në lote:

Procedura nuk ndahet në lote, pasi proceset që përbëjnë objektin e kontratës janë teknikisht dhe funksionalisht të ndërlidhura dhe përbëjnë një proces unik e të vazhdueshëm pyllëzimi. Realizimi nga një operator i vetëm garanton vazhdimësinë e metodologjisë së punës, koordinimin e ndërhyrjeve dhe përgjegjësinë e unifikuar për rezultatin përfundimtar. Ndarja në lote do të fragmentonte përgjegjësinë dhe do të rriste rrezikun e vonesave apo mospërputhjeve ndërmjet fazave të punës. Për rrjedhojë, mosndarja në lote vlerësohet e nevojshme për garantimin e cilësisë, mbijetesës së fidanëve dhe mbrojtjen e investimit publik.

Si përfundim në përputhje me natyrën e objektit të kontratës dhe nevojën për garantimin e suksesit të investimit publik, autoriteti kontraktor vlerëson se kontrata nuk duhet të ndahet

në lote, pasi të gjitha proceset e punës duhet të realizohen nga një operator ekonomik i vetëm gjatë gjithë periudhës trevjeçare të zbatimit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **“Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.

- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; përkatësisht në vlerën: **532,748.1 (pesëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet e tetë pikë një) lekë ose 5,783.19 (pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre pikë nëntëmbëdhjetë) euro**. Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankës të Shqipërisë datë 04.09.08.2026 është 92.12.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”
“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhë...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standartet e kërkuara të cilësisë, me qëllim garantimin e cilësisë së realizimit të kontratës, mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë e shëndetit në punë gjatë ekzekutimit të saj përfshirë:

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **certifikatë ISO 9001-2015** ose ekuivalentin (të përditësuar), lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë garanton që operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit të cilësisë, duke siguruar planifikim, organizim dhe kontroll efektiv të proceseve që lidhen me objektin e prokurimit, si dhe ofrimin e produkteve/shërbimeve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **certifikatë ISO 14001-2015** ose ekuivalentin (të përditësuar), lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë dëshmon se operatori ekonomik disponon një sistem të menaxhimit mjedisor, i cili mundëson kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve në mjedis gjatë realizimit të kontratës, në përputhje me praktikën e mira dhe legjislacionin në fuqi. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **certifikatë ISO 45001-2015** ose ekuivalentin (të përditësuar), lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë vërteton se operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, duke garantuar masat për parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e punonjësve gjatë realizimit të kontratës. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për **xhiron vjetore** për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar- Shërbim" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave

nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet gjatë vitit 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të **certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025)** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihen **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe adresat sekondare.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me **vlerë jo më e vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Për kontratat e realizuara si *bashkim operatorësh*, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë dhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
 - Për kontratat e realizuara si *Nënkontraktor*, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor stafin si më poshtë:

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **28 (njëzet e tetë) punonjës**. Ky numër punonjësish është i nevojshëm për realizimin në kohë të punimeve të parashikuara në preventiv.

Numri total i ditëve të punës të llogaritura në preventivin e punimeve sipas normave të punimeve në pyje (Vendimi nr.839, datë 13.12.2025), në raport me numrin e ditëve të punës që një punëtor duhet të realizojë gjatë 1 muaji (22 ditë pune) rezulton të jetë prej 247 punëtorësh. Ky numër punëtorësh i shpërndarë sipas grafikut të parashikuar për realizimin e punimeve prej 9 muajsh pune efektive (periudha e pushimit të vegjetacionit për realizimin e mbjelljeve dhe të zëvendësimeve, si dhe muaji qershor-korrik për kryerjen e shërbimeve silvi-kulturale), del një numër mesatar punëtorësh mujor prej 28 personash, sipas tabelës më poshtë:

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën muajin e fundit ose me anë të listëpagesave të punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

b) **(një) Drejtues Teknik** për realizimin e kontratës, i cili duhet të jetë inxhinier pyjesh, e vërtetuar kjo me kontratë pune (të vlefshme), diplomë, librezë pune, CV dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë.

- Drejtuesi teknik duhet të jetë i pajisur me certifikatën (të vlefshme) e lëshuar nga Ministria përkatëse si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave.

Kjo Çertifikatë garanton eksperiencën dhe profesionalizmin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Për faktin që ekzekutimi i punimeve zbatohet specifikisht në fondin pyjor dhe kriteret teknike si të skemës mbjelljes, metodës së përgatitjes së tokës si dhe njohjes në detaje të materialit mbjellës (lloji, mosha dhe plotësimi i kriterëve të standarteve teknike të materialit mbjellës) kërkojnë ekspertizë të fushës së pyjeve.

c) Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate nga Administratori i shoqërisë së ky Drejtues Teknik duhet** të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik me kohë të plotë pune dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera me qëllim që të ndjekë procesin e pyllëzimeve. Për inxhinierin e pyjeve duhet të paraqitet dokumentacioni provues, Kontratë pune e vlefshme (përkatëse), diplomë, librezë pune, cv. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili/ose njëri nga Operatorët duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik).*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

d) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit/ose me kontratë si më poshtë:

2 (dy) shofer. Për këto punonjës duhet të paraqitet leje drejtimi (e vlefshme), dëshmi e aftësisë profesionale/patente manovrimi e lëshuar nga “Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” (e vlefshme), librezë pune, kontratë pune (e vlefshme).

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- e) **1(një) agronom**, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë, librezë pune, cv dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- f) **1 (një) punonjës** i cili të disponojë certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (i ndryshuar).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kritere janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarrëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjet ndaj emergjencave dhe ekspertit për siguri dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve.

Në mbështetje të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier” Autoriteti kontraktor duke vlerësuar të gjitha detyrat që mbulojnë këta punonjës për sigurinë në kantier ka gjykuar të jenë pjesë e stafit një punonjës i certifikuar pasi duhet të kryejë funksione të tilla të rëndësishme në kantier si mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve; caktojnë kufijtë dhe përgatitin zonën e stokeve dhe të depozitimit të materialeve, në veçanti kur bëhet fjalë për lëndë dhe substanca të rrezikshme; përshtatin në funksion të zhvillimit të kantierit, të kohëzgjatjes efektive që duhet t'i jepet llojeve të ndryshme të punës ose fazave të punës; kryejnë bashkëpunimin midis punëdhënësve dhe punëmarrësve të pavarur; kryejnë bashkëveprimin me aktivitetet që ndodhin në vendndodhje, brenda dhe në afërsi të kantierit.

Operatori ekonomik duke angazhuar punonjës të kualifikuar dhe me eksperience, vlerëson rëndësinë e projektit në fjalë rrit performancën e realizimit të projektit, rrit vlerën e investimit njerëzor në projekt dhe në këtë mënyrë siguron suksesin e përbashkët.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamionçinë me kapacitet mbajtës nën 1 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Depozita uji 2000 l	3 copë	Në pronësi ose me qera

Kamionçina parashikohet si mjet i domosdoshëm logjistik për realizimin e projektit, me funksion transportin e materialeve, pajisjeve dhe stafit teknik në terren, duke garantuar zhvillimin efikas dhe në kohë të aktiviteteve të planifikuara.

-Autobot uji dhe Depozitë uji janë parashikuar që të jenë në funksion të shërbimeve silvi-kulturale të bimësisë së instaluar si rezultat i procesit të mbjelljes.

1) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik;

2) Siguracion mjeti (i vlefshëm);

3) Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)

c) Leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm);

4) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme);

- Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se disponon edhe vegla të ndryshme pune dhe pajisje të mbrojtjes personale në punë, si më poshtë:

Nr	Baza materiale	Njësia	Sasia
1	Bela	copë	min. 35
2	kazmë	copë	min. 35
3	Shat për prashitje	copë	min. 35
4	Sharrë dore	copë	min. 5
5	Gërshërë krasitëse	copë	min. 5
6	Doreza mbrojtëse	palë	min. 35
7	Zorrë uji	ml	min 100

1) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes;

2) **Për mjetet dhe pajisjet teknike** që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë *foto* të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij;

3) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, nëpërmjet së cilës:

- deklaron se mjetet dhe pajisjet e paraqitura sipas pikës 2.3.3 janë në dispozicion për realizimin e kontratës dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese nga Autoriteti Kontraktor;
- pranon të lejojë verifikimin e tyre nga Autoriteti Kontraktor në çdo kohë gjatë procedurës së prokurimit dhe deri në përfundimin e kontratës;
- deklaron vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve të paraqitura për qëllime verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenin 41 pika 6 ku citohet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për kryerjen e shërbimit për permbushje me suksese të kontratës objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Këto të fundit për objektin e prokurimit **“Pyllëzim me akacie”**, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që e vlerëson këtë shërbim si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Specifikimet teknike

Specifikimet teknike janë trajtuar në projektin e miratuar nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, me nr.404/1 prot., datë 22.04.2026, regjistruar pranë APR-së me nr.1023/3 prot., datë 24.04.2026.

Projekti është hartuar për pyllëzimin me akacie të nën/ngastrës 71/c në një sipërfaqe prej 20 ha, në ekonominë pyjore Baldushk.

Fidanët pyjor të llojit akacie duhet të jenë 2 vjeçar pa bukë dheu, të llojit “Akacie {Robinia pseudoacacia L.}”, fidanët duhet të kenë sistem rrënjor të zhvilluar mirë, të pa dëmtuar, pa pjesë të thara. Trupi të jetë i drunjëzuar, i pa dëmtuar, i drejtë, i pa bigëzuar, me sytha të zhvilluar normalisht dhe të pa çelur. Fidani të jetë i pa prekur nga sëmundje apo dëmtues, gjithashtu të jetë i freskët dhe jo i mpirë nga ngricat apo mungesa e lagështirës.


Standartet teknike të materialit mbjellës

Nr.	Lloji i fidanit	Pyllëzime në blloqe		
		Trashësia e qafes (mm)	Gjatësia e fidanit (cm)	Gjatësia e rrënjës (cm)
A	Fletorë	≥ 10 - 15	≥ 100 - 120	≥ 25 - 30
1	Akacie pa tokë Robinia pseudoacacia L	≥ 10	≥ 100	≥ 25

Çertifikime

Fidanët e llojit Akacie (Robinia pseudoacacia) duhet të jenë të çertifikuar {me çertifikatë origjine dhe cilësie (fitosanitare)}, brenda standarteve shtetërore.

Skema e mbjelljes brënda ngastrës



Skema e mbjelljes është 2 x 2 m. Duke mbajtur parasysh konfiguracionin e terrenit si dhe nevojën e llojit të zgjedhur për ushqim e dritëzim, kjo skemë garanton zhvillim normal por në përshtatshmëri me formën, pjerrësinë e terrenit dhe pjesmarjen e llojit dëllënjë e kuqe të shperndarë nëpër n/ngaster, kjo skemë mund të moderohet por numri i fidanëve për ha nuk duhet të zbresi poshtë 2500 copë/ha.

Përpara mbjelljes, do të bëhet piketimi i gropave. Gropat do të kenë përmasa 40 x 40 x 40 cm. Largësia midis gropave do të jetë 2 x 2 m ku në 1 ha do të hapen 2 500 gropat.

Metoda e pyllëzimit zgjidhet në vartësi të kushteve stacionale të objektit dhe veçorive biologjike të llojit që propozohet të mbillet. Për zgjedhjen e metodës së pyllëzimit, duhet të bëhet krahasim i avantazheve dhe disavantazheve të secilit faktor, duke propozuar atë më të përshtatshmen. Duke patur në konsideratë faktet e mësipërme si dhe qëllimin e pyllëzimit, është propozuar metoda e pyllëzimit me fidanë.

Mënyra e përgatitjes së tokës

Gjatë zbatimit të këtij projekti, do të kryhen punime pyllëzimi duke respektuar të gjithë parametrat teknik të proceseve të punimeve të planifikuara, që nga piketimi, hapja e gropave, ruatja e skemës së pyllëzimit, shtratifikimi dhe nxjerrja e fidanëve, mbjellja e tyre si dhe shërbimet kulturore për tre vite.

Gjatë hapjes së gropave, dheu i gërmuar do të vendoset i ndarë nga njëri-tjetri {në shtresa}. Gjatë hapjes së gropave, gjysma e dheut {e shtresës së sipërme} do të hidhet në krahun e majtë të gropës, ndërsa gjysma tjetër {e shtresës së poshtme} në krahun e djathtë. E kundërta do të ndodhë gjatë procesit të mbushjes e mbjelljes së fidanit. Mbjellja e fidanëve të bëhet në periudhën e pushimit të vegjetacionit, në ditë pa ngrica, në mënyrë që të mos dëmtohet sistemi rrënjor i tyre nga ngricat.

Transporti i fidanëve, brenda parcelës do bëhet me krahë.

Mbjellja e fidanit do të bëhet nga dy punëtorë të specializuar dhe instruktuar paraprakisht nga specialistët përkatës për mënyrën e kryerjes së këtij procesi. Në fillim do të hidhet në gropë dheu i shtresës së sipërme të ndarë gjatë hapjes së gropës. Para mbjelljes duhet të kontrollohet sistemi rrënjor i fidanit. Në rast se ka rrënjë të përdredhura, ato shkurtohen me kujdes me gërshërë të posaçme.

Fidanët që do të përdoren për mbjellje do të jenë fidanë 2 vjeçarë, pa bukë dheu, të llojit akacie të çertifikuar { *me çertifikatë origjine dhe cilësie* }, brenda standarteve shtetërore.

Punimet përgatitore: Në fillim janë piketimi dhe hapja e gropave, ndërsa procesi i mbjelljes do të bëhet gjatë periudhës së pushimit të vegjetacionit.

Grafiku i punimeve të pyllëzimit

Aktiviteti	Muajt						Grupi i implementimit
	{kutitë e selektuara tregojnë aktivitetet e planifikuara, nga muaji i parë i zbatimit të projektit}						
	10	11	12	01	06	07	
A. Viti I							
A1.Njohja me objektin ku do të realizohen punimet.							Stafi i D.A.P.K, drejtues i subjektit kontraktues.
A2.Sigurimi i fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e punimeve.							Stafi drejtues i subjektit kontraktues.
A3.Trajnimi i punëtorëve që do merren me realizimin e punimeve.							Stafi i D.A.P.K, Stafi drejtues i subjektit kontraktues.
A4.Piketimi sipas skemës së mbjelljes.							Stafi i subjektit, drejtuesi teknik, punëtorët e trajnuar.
A5.Hapja e gropave dhe kontrolli i cilësisë së tyre.							Stafi i subjektit, drejtuesi teknik, punëtorët e trajnuar.
A6.Sigurimi i fidanëve cilësor dhe të çertifikuar, transporti, shtratifikimi i fidanëve.							Stafi i subjektit të kontraktuar.
A7.Mbjellja e fidanëve, duke respektuar teknikën e zbatimit të punimeve.							Stafi i subjektit, drejtuesi teknik, punëtorët e trajnuar.
A8. Kontrolli i punimeve dhe hartimi i dokumentacionit përkatës.							Grupi i monitorimit { Specialistët e D.A.P.K Drejtuesi Teknik i subjektit}.
B. Viti II							
B1.Pyllëzime							
B2.Zëvendësime							
B3.Shërbime Silvi-kulturale							
C. Viti III							
C1.Shërbime Silvi-kulturale							

Për realizimin e punimeve të pyllëzimit sipas grafikut të punimeve janë parashikuar 9 muaj punë efektive që përkojnë me periudhën e pushimit të vegjetacionit për pyllëzimet (viti I) dhe zëvendësimet (viti II), si dhe periudhën qershor-korrik për shërbimet kulturale (viti II dhe III).

- * Pyllëzimet (punime përgatitore, hapje e gropave dhe mbjellje) do të kryhen në sezonin tetor, nëntor, dhjetor (viti I).
- * Zëvendësimet do të kryhen në sezonin nëntor-dhjetor të vitit pasardhës (viti II).
- * Shërbimet silvi-kulturale do kryhen gjatë periudhës qershor-Korrik, respektivisht në dy sezone pasardhëse (viti II dhe III).

Kohëzgjatja e realizimit të kontratës do të jetë nga data e nënshkrimit deri me datë 30 dhjetor të vitit 2028.

***Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim**